



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Protokolli



Kartelë Shoqëruese e Praktikës

Dërgues KESH

Nr. 428/3 Prot. Datë 16.5.2016

Nr. Prot Hyrës 340/4 Datë 17.5.2016

Objekti i

Korrespondencës: Derrbet shpikimi pentarçje nga KESH sh.a
per periudhen 1.07.2016 - 31.12.2016

Shënime të Kryetarit

Për t'u
trajtuar Nga Drejtorite Teknike

Shënim: Në rekomendjen tuaj - Drejtoria
e Komiteteve dhe Tarifave të
Shqyrtuar me vëmendje aplikimin dhe
respektuar procedurat e EREs.

Për
dijeni: Bacolit 19.05.2016

Afati: Normal ___ ditë Prioritet ___ ditë Urgjent ___ ditë

Marrë në dorëzim nga Drejtori i
Drejtorisë _____ Datë _____

Shënim i Drejtorit të Drejtorisë
përkatëse: _____

Marrë në dorëzim nga Përgjegjësi ose Specialisti i
Sektorit _____ Datë _____

Shënim i Përgjegjësit ose Specialistit të
Sektorit: _____

Praktika u përpunua nga _____ Datë _____

Dorzuar _____ Datë _____

Përgjigjja kthehet nga _____ Datë _____



KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE

DPMS/DZHB - DMK/SPF - SÇRR Nr. 4218/Prot.
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 16 / 05 / 2016

340/4
17.5.2016
H. Buzuku

Drejtuar: **Z. Petrit AHMETI**
Kryetar i Bordit të ERE

Lënda: **Dërgohet aplikimi për tarifë nga KESH sh.a për periudhën 01.07.2016-31.12.2016.**

I nderuar z. Kryetar i Bordit të ERE,

Në vijim të shkresës suaj Nr. 340/1 Prot, datë 06.05.2016 me objekt "Kërkesë për Aplikim", bashkëlidhur po ju paraqesim aplikimin për tarifën nga KESH sh.a për periudhën 01.07.2016-31.12.2016.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Me respekt,

ADMINISTRATORI

Agron HËTOJA





KORPORATA
ELEKTROENERGJETIKE
SHQIPTARE

APLIKIMI
PËR TARIFËN E PRODHIMIT DHE TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR
PERIUDHËN 1 KORRIK 2016 – 31 DHJETOR 2016

MAJ 2016



PËRMBAJTJA

1	QËLLIMI.....	3
2	PERIUDHAT RREGULLATORE 2012–2014, 2015 DHE 6-MUJORI I PARË I VITIT 2016	4
2.1	TARIFAT PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014	4
2.2	TARIFAT E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2015	8
2.3	TARIFAT PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2016 – 30 QERSHOR 2016	10
2.3.1	Realizimi i Pritshëm i Tarifës për KESH GEN (1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016)	10
2.3.2	Realizimi i Pritshëm i Tarifës për FPSH (1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016)	13
3	KËRKESA E KESH PËR TARIFËN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2016	16
3.1	PARASHIKIMI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE	16
3.2	LLOGARITJA E TARIFËS SË PRODHIMIT DHE TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE	17
3.3	KONKLUZIONE.....	21



Në zbatim të detyrimit për shërbim publik të parashikuar në ligjin Nr.43/2015, datë 30.04.2015 "për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe të vendosur për KESH sh.a me VKM Nr.224, datë 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energjie elektrike", në vijim paraqesim relacionin e aplikimit të KESH sh.a për tarifën e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016.

1 QËLLIMI

Ky dokument ka për qëllim të prezantojë në mënyrë të arsyetuar dhe mbi bazë argumentesh kërkesën e shoqërisë KESH sh.a drejtuar Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me tarifën e propozuar të prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike për KESH sh.a për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016.

Tarifa e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike e propozuar nga KESH sh.a krijon mundësinë e ushtrimit normal të aktiviteteve të prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike që shkon për furnizimin me energji elektrike të klientëve fundorë që përfitojnë nga Furnizimi i Shërbimit Universal. Përlllogaritja në mënyrë sa më të drejtë, transparente dhe jo diskriminuese e tarifës së prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016 përbën një kusht të rëndësishëm dhe domosdoshëm për përmirësimin e situatës financiare të shoqërisë KESH sh.a.

Nëpërmjet tarifës së propozuar KESH sh.a ka mundësinë reale të orientohet drejtë në tregun e energjisë elektrike dhe të funksionojë si një shoqëri tregtare e cila me burimet e veta dhe në mënyrë financiarisht të pavarur nga Buxheti i Shtetit, arrin të garantojë mbulimin e të gjitha shpenzimeve operative të vitit si edhe koston lokale të investimeve.

Propozimi ynë për tarifën e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016 është hartuar duke u bazuar në parashikimet e ligjit Nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe VKM Nr. 244, datë 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energjie elektrike".

Gjithashtu përlllogaritja e tarifës së prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a është kryer duke marrë parasysh gjithashtu edhe frymën e reformave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare me vendimin Nr. 171, datë 25.02.2015 "Për miratimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike".

Propozimi i një tarife të tillë ka për qëllim përfundimtar shfrytëzimin optimal të njësive gjeneruese të energjisë elektrike në administrim të KESH sh.a, duke ofruar për klientët tariforë prodhimin dhe tregtimin e energjisë elektrike me kosto sa më të ulët.

2 PERIUDHAT RREGULLATORE 2012–2014, 2015 DHE 6-MUJORI I PARË I VITIT 2016

2.1 TARI FAT PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014

- Nga ana e ERE-s me Vendimin Nr. 144, datë 07.12.2011 u vendos tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për Periudhën e Tretë Rregullatore (2012-2014), e cila ishte 1.00 lekë/kWh.
- Nga ana e ERE-s me Vendimin Nr. 145, datë 07.12.2011 u miratua tarifa e energjisë për Furnizuesin Publik me Shumicë për Periudhën e Tretë Rregullatore (2012-2014), e cila ishte 2.83 lekë/kWh.
- Nga ana e ERE-s me Vendimin Nr. 87, datë 29.06.2012 u vendos rishikimi i tarifës së energjisë për Furnizuesin Publik me Shumicë për Periudhën e Tretë Rregullatore (2012-2014), e cila ishte 2.20 lekë/kWh. Ky rishikim u shoqërua dhe me akomodimin e efekteve financiare të Vendimit Nr.80, datë 15.02.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s mbi "Miratimin e Studimit mbi Borxhin e Keq për shoqërinë CEZ Shpërndarje".
- Nga ana e ERE-s me Vendimin Nr. 149, datë 07.12.2011 u miratua çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitin 2012, e cila ishte 9.30 lekë/kWh.
- Nga ana e ERE-s me Vendimin Nr. 144, datë 26.12.2014 u vendos rishikimi i çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitin 2013 dhe 2014, e cila ishte respektivisht 9.73 lekë/kWh për vitin 2013 dhe 7.95 lekë/kWh për vitin 2014. Në këtë vendim kërkohej dhe akomodimi i efekteve financiare për këtë periudhë.
- Nga ana e ERE-s me Vendimin Nr. 150, datë 07.12.2011 u përcaktua çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW për vitin 2012, e cila ishte 7.77 lekë/kWh.
- Nga ana e ERE-s me Vendimin Nr. 143, datë 26.12.2014 u vendos rishikimi i çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitet 2013 dhe 2014, e cila shkonte në 7.53 lekë/kWh, ku kërkohej dhe akomodimi i efekteve financiare për këtë periudhë.
- Nga ana e ERE-s me Vendimin Nr. 150, datë 07.12.2011 u vendos përcaktimi i çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW për vitin 2012, e cila ishte 7.77 lekë/kWh.
- Nga ana e ERE-s me Vendimin Nr. 151, datë 07.12.2011 u vendos përcaktimi i çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga TEC Vlorë sh.a. tek Furnizuesi Publik me Shumicë për Periudhën e Tretë Rregullatore (2012-2014). Tarifa fikse për aktivitetin e prodhimit të TEC Vlorë sh.a. për vitin 2012 ishte 1.211 milionë lekë/MW/muaj. Tarifa variable e shitjes së energjisë elektrike tek KESH sh.a. ishte 21.4 lekë/kWh.

Më poshtë do të gjeni llogaritjet e tarifave të KESH-Gen. dhe FPSH për Periudhën e Tretë Rregullatore (2012-2014), të aprovuar nga ERE dhe realizimin e tyre nga KESH sh.a (KESH Gen. dhe FPSH), si dhe transaksionet e tjera të shit-blerjes së energjisë që ka shërbyer për furnizimin e OSHEE për mbulimin e humbjeve.

Zërat	Njësia	Miratuar ERE			Realizuar nga KESH Gen.			Diferenca	Dif. %
		2012	2013	2014	2012	2013	2014		
Materiale dhe Produkte	(mil/lekë)	212	205	215	632	79	170	300	48%
Personeli	"	995	1,046	1,100	3,141	742	805	735	23%
Furnitura e Shërbime	"	680	716	755	2,151	762	1,280	(405)	-19%
Totali OPEX	(mil/lekë)	1,887	1,967	2,070	5,924	1,582	2,167	630	11%
Vlera e asetëve	(mil/lekë)	34,257	36,528	40,143	110,928	29,545	30,659	20,799	19%
Amortizimi i akumuluar	"	6,543	7,223	7,939	21,705	6,511	7,768	232	1%
Vlera neto e Asetëve	(mil/lekë)	27,714	29,305	32,204	89,223	23,033	22,731	20,567	23%
Kapitali i Punës	(mil/lekë)	157	164	173	494	396	542	(830)	-168%
Investime	"	2,271	3,615	2,446	8,332	380	734	3,178	38%
Amortizim i vitit	"	680	716	755	2,151	683	672	90	4%
Baza e Rregulluar e Asetëve (RAB)	(000/lekë)	29,462	32,368	34,068	95,898	22,936	22,967	25,403	26%
Kthimi i Lejuar mbi Kapitalin pas Taksave	(%)	7.34%	7.34%	7.34%	7.34%	7.34%	7.34%	0	0%
Raporti i Synuar i Kapitalit të Vet	"	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%	0	0%
Kosto Mesatare e borxhit	"	5.26%	4.80%	4.50%	4.85%	5.26%	4.80%	0	0%
Raporti i Synuar i Borxhit	"	60.00%	60.00%	60.00%	60.00%	60.00%	60.00%	0	0%
WACC (Weighted Average Cost of Capital)	(%)	6.09%	5.82%	5.64%	5.85%	6.09%	5.82%	0	0.00%
Fitimi	(000/lekë)	1,794	1,882	1,921	5,598	1,397	1,336	1,478	26%
Të ardhura nga interesat	"	(1,001)	(901)	(802)	(2,704)	(413)	(132)	(2,041)	75%
Të Ardhurat e Kërkuara	(000/lekë)	3,361	3,666	3,944	10,969	3,249	4,045	157	1%
Axhustim i të ardhurave	"	596		596		596		0	0%
Të Ardhurat e Kërkuara minus Të Ardhurat	"	3,957	3,666	3,944	11,565	3,845	4,045	157	1%
Energjia Netë e Prodhuar	GWh	3,837	3,837	3,837	11,511	4,027	5,812	(1,764)	-15%
Tarifa Mesatare e Prodhimit e KESH Gen. për periudhën 2012-2014 (lekë/kWh)	lekë/kWh	1.03	0.96	1.03	1.00	0.95	1.02	0.15	14%

Zërat	Njësia	Miratuar ERE			Realizuar nga FPSH			Diferenca	Dif. %
		2012	2013	2014	2012	2013	2014		
Blerje energji nga Prodhuesi Publik	(GWh)	3,611	3,609	3,610	10,830	2,648	3,161	2,074	19%
Çmimi i prodhimit të energjisë elektrike	(lekë/kWh)	1.03	0.96	1.03	1.00	1.00	1.00	0.00	0%
Kosto Totale e Prodhimit Publik	(mil. lekë)	3,724	3,448	3,711	10,883	2,648	3,161	2,127	20%
Importi i energjisë	(GWh)	0	33	193	226	262	180	(216)	-96%
Kosto e importit	(lekë/kWh)	8.02	8.02	8.06	8.05	10.31	7.61	(1.00)	-12%
Kosto Totale e Importit	(mil. lekë)	0	265	1,556	1,820	2,705	1,298	(2,183)	-120%
Blerje energjie nga PVE	(GWh)	228	270	280	778	291	730	(791)	-102%
Çmimi i PVE	(lekë/kWh)	8.10	8.30	8.20	8.21	8.67	9.02	(0.71)	-9%
Kosto Totale e PVE	(mil. lekë)	1,847	2,241	2,296	6,384	2,523	6,581	(7,602)	-119%
Blerje energjie nga TEC Vlorë	(GWh)	72	0	0	72	0	0	72	100%
Kosto e TEC Vlorë	(lekë/kWh)	21.41	21.41	21.41	21.41	21.41	21.41	0.00	0%
Kosto Totale e TEC Vlorë	(mil. lekë)	1,542	0	0	1,542	1	0	1,541	100%
Blerje energjie nga Hec Ashta	(GWh)	8.30	8.30	8.30	8.30	0.00	203	(415)	100%
Çmimi i Hec Ashta	(lekë/kWh)	8.30	8.30	8.30	8.30	8.28	8.29	0.01	0%
Kosto Totale e IPP të ndarë	(mil. lekë)	0	0	0	0	1,749	1,686	(3,435)	100%
Blerje energjie nga IPP e ndarë	(GWh)	200	363	363	926	398	31	244	26%
Çmimi i IPP të ndarë	(lekë/kWh)	3.14	3.14	3.14	3.14	2.78	6.25	0.11	3%
Kosto Totale e IPP të ndarë	(mil. lekë)	628	1,140	1,140	2,908	1,107	193	840	29%
Kosto Totale e Energjisë	(mil. lekë)	7,740	7,093	8,702	23,536	8,984	12,919	(8,714)	-37%
Shpenzime për personelin	(mil. lekë)	31	31	32	94	22	24	23	25%
Material	"	2	2	2	6	1	1	3	43%
Furnitura e Shërbime	"	8	9	9	26	6	6	8	31%
Shpenzime për interesa	"	848	848	848	2,544	1,362	1,984	(2,585)	-102%
Kosto fikse TEC Vlorë	"	1,409	1,500	1,500	4,409	1,409	1,409	182	4%
Totali i të Ardhurat të Kërkuara	(mil. lekë)	10,038	9,483	11,093	30,615	11,784	16,144	(11,083)	-36%
Marzhi i Fitimit (0.5% e të ardhurave)	(mil. lekë)	46	43	51	140	59	81	(68)	-49%
Kompensim për llogaritjen e të ardhurave të FPSH për vitin 2011	"	5,200	697	697	5,897	5,200	697	0	0%
Kompensim i të ardhurave nga eksporti i vitit 2010	"	(2,050)	1,200	2,100	1,250	(2,050)	2,100	0	0%
Rillogaritje/kompensim i të ardhurave nga TEC Vlorë	"	(1,541)		(1,541)	(1,541)	(1,541)		0	0%
Totali i të Ardhurave të Kërkuara Neto	(mil. lekë)	11,693	10,726	13,941	36,361	13,452	19,022	(11,152)	-31%
Energjia e shitur	GWh	4,111	4,275	4,446	12,832	3,600	4,305	969	8%
Klientë Tariforë	"	"	"	"	"	"	"	"	"
Mbulim Humbje OSHEE	"	"	"	"	"	"	"	"	"
Tarifa Mesatare e FPSH-së 2012-2014 për klientët tariforë	lekë/kWh	2.84	2.51	3.14	2.82	3.74	4.42	(1.18)	-42%
Tarifa Mesatare e FPSH-së 2012-2014 për klientët tariforë ndryshuar me Vendimin e	lekë/kWh				2.20			(1.33)	-61%

Per Furnizimin e OSHEE për humbjet & Klientët e Kualifikuar	Realizuar nga FPSH			
	2012	2013	2014	2012-2014
Blerje nga importit per Furnizim te OSHEE per humbjet (VKM)				
Importi i energjise (GWh)	618	171		789
Kosto e Importit (lekë/kWh)	8.44	7.61		8.26
Kosto Totale e Importit (mil. lekë)	5,217	1,299	0	6,516
Marrë nga Prodhuesi Publik për humbjet e OSHEE				
Blerë energji nga Prodhuesi Publik (GWh)	975	1,761	96	2,832
Cmimi i prodhimit të energjisë elektrike (lekë/kWh)	1.00	1.00	1.00	1.00
Kosto Totale e energjise (mil. lekë)	975	1,761	96	2,832
Furnizim i OSHEE per humbjet (VKM)				
Sasia (GWh)	618	171		789
Cmimi i energjise (lekë/kWh)	8.44	7.61		8.26
Te Ardhura nga shitja (mil. lekë)	5,217	1,299	0	6,517
Furnizim i OSHEE (nga prodhimi)VKM per humbjet				
Sasia (GWh)		621		621
Cmimi i energjise (lekë/kWh)		4.11		4.11
Te Ardhura nga shitja (mil. lekë)	0	2,552	0	2,552
Furnizim i OSHEE per humbjet (kompesimi financiar i borxhit energjetik)				
Sasia (GWh)	975	1,139	96	2,210
Cmimi i energjise (lekë/kWh)	2.20	2.20	2.20	2.20
Te Ardhura nga shitja (mil. lekë)	2,145	2,507	211	4,863
Sasia (diferenca e faturuar ne muajin m+3) (GWh)	975	1,139	96	2,210
Cmimi i energjise (lekë/kWh)	7.10	5.09	6.41	6.03
Te Ardhura nga shitja (mil. lekë)	6,922	5,801	614	13,336

100% paguar nga FPSH

(Akhustuar në tarifën e vitit 2015)

84% e paarkëtuar 16% u ekzekutua me përmbanin

100% e pa arkëtuar

(Akhustuar në tarifën e vitit 2015)

100% e pa arkëtuar

Per Furnizimin e Klienteve te Kualifikuar si furnizues i alternativës së fundit	Realizuar nga FPSH			
	2012	2013	2014	2012-2014
Marrë nga Prodhuesi Publik per furnizimin e KK				
Blerë energji nga Prodhuesi Publik (GWh)	0	4		4
Cmimi i prodhimit të energjisë elektrike (lekë/kWh)	0	1.00	1.00	1.00
Kosto Totale e energjise (mil. lekë)	0	4	0	4
Furnizim i KK				
Sasia (GWh)	0	4		4
Cmimi i energjise (lekë/kWh)	0	12.62		12.62
Te Ardhura nga shitja (mil. lekë)	0	53	0	53

2.2 TARI FAT E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2015

- ERE, me Vendimin Nr. 139, datë 26.12.2014 përcaktoi tarifën e prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2015, e cila ishte 1.45 lekë/kWh.
- ERE, me Vendimin Nr. 140, datë 26.12.2014 përcaktoi tarifën e energjisë elektrike për Furnizuesin Publik me Shumicë për vitin 2015, e cila ishte 3.00 lekë/kWh.
- Nga ana e ERE-s me Vendimin Nr. 141, datë 26.12.2014 u përcaktua tarifa e shërbimeve ndihmëse të KESH sh.a. për vitin 2015, e cila ishte 158 lekë/MWh.
- Nga ana e ERE-s me Vendimin Nr. 27, datë 16.02.2015 u përcaktua tarifa fikse e energjisë për vitin 2015 që do t'i paguhej prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet (privatë dhe me koncesion), e cila ishte 7.636 lekë/kWh.
- Me shkresën Nr.502/9 Prot., datë 04.12.2015 të ERE-s, sqarohet tarifa e energjisë elektrike për energjinë e prodhuar nga HEC Lanabregas e cila është e njëjtë me hidrocentralet (privatë dhe me koncesion), pra 7.636 lekë/kWh.

Bashkëngjitur do të gjeni llogaritjet e tarifave të KESH Gen dhe FPSH për vitin 2015, të aprovuar nga ERE dhe realizimin e tyre nga KESH sh.a në funksionet e KESH Gen dhe FPSH.

Zërat	Njësia	Aplikuar nga KESH 2015	Miratuar ERE 2015	Realizuar nga KESH 2015	Diferenca 2015
Materiale dhe Produkte	(000/lekë)	215,643	215,643	120,770	(94,873)
Personeli	"	973,146	973,146	1,036,651	63,505
Furnitura e Shërbime	"	560,326	560,326	524,542	(35,784)
Totali OPEX	(000/lekë)	1,749,115	1,749,115	1,681,963	(67,151)
Vlera e asetëve	(000/lekë)	32,679,000	32,683,000	33,332,804	649,804
Amortizimi i akumuluar	"	8,474,000	8,628,000	8,473,772	(154,228)
Vlera neto e Asetëve	(000/lekë)	24,205,000	24,055,000	24,859,032	804,032
Kapitali i Punës	(000/lekë)	437,279	437,279	420,491	(16,788)
Investime	"	6,053,000	5,046,000	2,361,859	(2,684,141)
Amortizimi i vitit	"	1,026,000	1,026,000	988,372	(37,628)
Baza e Rregulluar e Asetëve (RAB)	(000/lekë)	26,642,779	28,512,279	26,653,009	(1,859,269)
Kthimi i Lejuar mbi Kapitalin pas Taksave	(%)	3.46%	3.46%	3.46%	0.00%
Raporti i Synuar i Kapitalit të Vet	"	40.00%	40.00%	40.00%	
Kosto Mesatare e borxhit	"	1.72%	1.71%	1.84%	0.13%
Raporti i Synuar i Borxhit	"	60.00%	60.00%	60.00%	
WACC (Weighted Average Cost of Capital)	(%)	2.42%	2.41%	2.49%	0.08%
Fitimi	(000/lekë)	643,752	687,213	663,190	-24,023
Të ardhura nga interesat					
Kosto fikse/shërbim borxhi TEC Vlorë	(000/lekë)	1,523,000	1,531,000	1,538,416	7,416
Të Ardhurat e Kërkuara	(000/lekë)	4,941,867	4,993,328	4,871,941	-121,387
Energjia Neto e Prodhuar	MWh	3,433,226	3,433,226	4,451,975	1,018,749
Tarifa E Kerkuar KESH GEN	lekë/kWh	1.44	1.45	1.09	(0.36)

Zërat	Njësia	Aplikuar nga	Miratur	Realizuar nga	Diferenca
		FPSH 2015	ERE 2015	FPSH 2015	
Blerë energji nga Prodhuesi Publik	(MWh)	3,247,836	3,247,836	3,539,826	291,990
Çmimi i prodhimit të energjisë elektrike	(lekë/kWh)	1.44	1.45	1.09	
Kosto Totale e Prodhimit Publik	(mijë lekë)	4,675,012	4,723,694	3,873,747	(849,947)
Importi i energjisë	(MWh)	142,000	142,000	355,686	213,686
Kosto e Importit	(lekë/kWh)	7.17	7.17	6.79	
Kosto Totale e Importit	(mijë lekë)	1,018,452	1,018,452	2,415,564	1,397,111
Blerje energjie nga PVE	(MWh)	885,000	885,000	765,204	(119,796)
Çmimi i PVE	(lekë/kWh)	9.02	6.64	7.64	1.00
Kosto Totale e PVE	(mijë lekë)	7,982,700	5,876,400	5,843,098	(33,302)
Blerje energjie nga TEC Vlorë	(MWh)			(1,872)	
Kosto e TEC Vlorë	(lekë/kWh)				
Kosto Totale e TEC Vlorë	(mijë lekë)				
Blerje energjie nga Hec Ashta	(MWh)	233,664	234,000	235,604	1,604
Çmimi i Hec Ashta	(lekë/kWh)	8.30	8.30	8.25	(0.05)
Kosto Totale e IPP të ndarë	(mijë lekë)	1,939,411	1,942,200	1,944,184	1,984
Blerje energjie nga HEC Lanabregas	(MWh)	35,500	35,500	31,242	(4,258)
Çmimi i IPP të ndarë	(lekë/kWh)	6.25	6.25	7.64	1.39
Kosto Totale e IPP të ndarë	(mijë lekë)	221,875	221,875	238,564	16,689
Kosto Totale e Energjisë	(mil. lekë)	15,837,451	13,782,621	14,315,156	532,535
Shpenzime për personelin	(mijë lekë)	30,097	30,097	30,097	-
Materiale	"	1,656	1,656	1,656	-
Furnitura e Shërbime	"	9,219	9,219	9,219	-
Shpenzime për interesa	"	1,771,619	1,771,619	1,519,142	(252,477)
Kosto fikse TEC Vlorë	"				
Totali i të Ardhurat të Kërkuara	(mijë lekë)	17,650,042	15,595,213	15,875,271	280,058
Marzhi i Fitimit (0.5% e të ardhurave)	(mijë lekë)	88,250	77,976	79,376	1,400
Axhustim për llogaritjen e të ardhurave të FPSH për periudhën rregullatore 2012 - 2014 per faturat e energjise per kompesimin e borxhit energjetik per pjesën e faturuar me tarifën 2.20 lekë/kWh	"	(2,030,928)	(2,030,928)	(2,030,928)	-
Të ardhurat e krijuara nga energjia e shitur për mbulim humbje OSHEE	"				
Totali i të Ardhurave të Kërkuara Neto	(mijë lekë)	15,707,364	13,642,261	13,923,719	281,458
Energjia e shitur	MWh	4,544,000	4,544,000	4,964,758	420,758
Klientë Tariforë	" "	4,554,000	4,554,000	4,508,564	(45,436)
Mbulim Humbje OSHEE	" "	-	-	456,128	456,128
Tarifa e FPSH	lekë/kWh	3.45	3.00	3.09	0.09

Gjatë vitit 2015 janë realizuar dhe të ardhura të tjera nga shitja e energjisë elektrike me çmime tregu dhe për mbulimin e humbjeve të OSHEE-së:

Energji e shitur me çmime tregu	MWh	753,568
Çmimi i shitjes	(lekë/kWh)	4.04
Të Ardhura nga shitja me çmime tregu	(mijë lekë)	3,043,566
Energji e shitur për mbulim humbje OSHEE	MWh	456,128
Çmimi i shitjes	(lekë/kWh)	4.77
Të Ardhura nga shitja mbulim humbje OSHEE	(mijë lekë)	2,176,849
Total Të Ardhura të tjera	(mijë lekë)	5,220,416

2.3 TARI FAT PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2016 – 30 QERSHOR 2016

- Nga ana e ERE-s me Vendimin Nr. 156, datë 24.12.2015 u vendos lënia në fuqi e vendimeve nr. 139, nr.140, nr.141, nr.145, nr.147, nr.148 datë 26.12.2014 dhe të vendimit nr. 27 datë 16.02.2015 për periudhën 1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016, për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike të miratuara me vendimet në fjalë.
- Nga ana e ERE-s me vendimin nr. 13, datë 16.02.2016 u miratua tarifa fikse e energjisë elektrike që do t'u paguhej prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet (privatë dhe koncesion) për vitin 2016, e cila ishte 7.448 lekë/kWh.

Më poshtë do të gjeni përlogaritjet e tarifave për KESH Gen dhe FPSH për periudhën 1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016, të aprovuar nga ERE dhe realizimin e tyre nga KESH sh.a (KESH Gen. dhe FPSH).

2.3.1 REALIZIMI I PRITSHËM I TARI FËS PËR KESH GEN (1 JANAR 2016 – 30 QERSHOR 2016)

Shpenzime Materiale dhe Produkte – Për periudhën 1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016 shpenzimet për materiale dhe produkte pritet të realizohen në vlerën prej 103 milion Lekë. Për vitin 2016 këto shpenzime janë planifikuar në rreth 211 milion lekë bazuar në nevojën për mirëmbajtje të njësive të prodhimit, Aparatit Qendër dhe shoqërisë TEC Vlora sh.a.

Shpenzimet e personelit

Bazuar në treguesit operacional të vitit 2015 dhe në treguesit e aprovuar të Programit të Ndryshuar Ekonomiko-Financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2016, shpenzimet e personelit për periudhën 1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016 parashikohen të jenë 556 milion lekë. Duke qenë se TEC Vlora sh.a. vazhdon të jetë në status konservimi, detyrimet dhe shpenzimet e kësaj shoqërie vazhdojnë të mbulohen nga aktiviteti i KESH sh.a.. Për këtë arsye edhe shpenzimet përkatëse janë llogaritur si pjesë e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike.

Numri mesatar i punonjësve të KESH Total është 750 duke përfshirë dhe personelin e KESH Qendër dhe TEC Vlora sh.a..

Shpenzimet për furnitura dhe shërbime – Për periudhën 1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016 pritet të realizohen në vlerën prej 246 milion lekë. Për vitin 2016 këto shpenzime janë planifikuar në rreth 763 milion lekë bazuar në nevojën për furnitura dhe shërbime të njësive të prodhimit, Aparatit Qendër dhe shoqërisë TEC Vlora sh.a.

Shpenzimet e Amortizimit – Për periudhën 1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016 pritet të jenë në vlerën prej 1,026 milion lekë. Për vitin 2016 këto shpenzime janë planifikuar në rreth 2,059 milionë lekë.

Për vitin 2016, bazuar dhe në Investimeve a parashikuara të kryhen si pjesë e Programit Ekonomiko-Financiar të shoqërisë, shtesat në aktivet afatgjata pritet të jenë rreth 7,352 milion lekë, nga të cilat 1,976 milion lekë nga Projekti i Sigurisë së Digave, i cili financohet nga kreditorët e huaj.

Baza e Aktiveve të Rregulluara (RAB)

Llogaritja e RAB bazohet në koston historike të aktiveve afatgjata në përdorim deri më 31.12.2015, kapitalin e punës, i cili për periudhën 1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016, që llogaritet i barabartë me 1/12 e OPEX –it të planifikuar. Llogaritja e kapitalit të punës bazohet në ritmin e shlyerjes së faturave të shitjes së energjisë elektrike, për atë pjesë të energjisë së shitur për mbulimin e kërkesës së klientëve tariforë. Arkëtimi i faturës mujore të shitjes së energjisë elektrike bazohet në Marrëveshjen për furnizim me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë OSHEE sh.a. (furnizuesi publik me pakicë) për vitin 2015, miratuar nga ERE me vendimin nr. 11 datë 04.02.2015, shtesat e aktiveve që pritet të kapitalizohen brenda periudhës 1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016 (3,676 milionë lekë) dhe amortizimin e AQT-ve për periudhën, që llogaritet të jetë 1,026 milionë lekë.

Llogaritja e Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit (WACC)

Kthimi mbi kapitalin (ROE): bazohet në rezultatet e ankandeve të Bonove të Thesarit 12 mujore të kryera nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2015. Mesatarja e periudhës e llogaritur deri në ankandin e fundit të zhvilluar për TB 12M është 3.27 %.

Kosto mesatare e borxhit: llogaritet në metodologjinë e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike, si raport i shumës totale të interesave neto për t'u paguar për kontratat e kredive afatgjata të KESH me gjendjen e principalit të këtyre kredive që KESH ka detyrim për të paguar. Kosto mesatare e borxhit e llogaritur për vitin 2016 është 1.84 %.

WACC – llogaritet mbi 60% e Interesit Mesatar të Kredive Afatgjata + 40% e ROE

$$WACC\ 2016\ (\%) = (60\% \times 1.84\% + 40\% \times 3.27\%) = 2.41\%$$

Fitimi (Kthimi mbi Bazën e Aktiveve të Rregulluara = RAB x WACC

Llogaritja e të ardhurave të pritshme për t'u realizuar nga KESH për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike përfshin elementët e mëposhtëm:

OPEX: Materiale dhe Produkte, Shpenzime Personeli, Furnitura dhe Shërbime: 905,309 (mijë lekë)

Amortizimi i periudhës 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016: 1,026,921 (mijë lekë)

Fitimi (Kthimi mbi RAB): RAB x WACC: 700,568 (mijë lekë)

Kosto fikse/Shërbim borxhi TEC Vlora: Bazuar në përshkrimin e gjendjes së shoqërisë TEC Vlora sh.a. si më sipër dhe në llogaritjen e tarifës së KESH Gen. për vitin 2015, kosto fikse e shërbimit të borxhit për TEC Vlorë për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016 llogaritet të jetë rreth 765 milionë lekë.

**Tarifa Mesatare e Prodhimit për periudhën 1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016
llogaritet në 1.38 lekë/kWh**

Rezultatet e ankandeve të Bonove të Thesarit 12 Mujore BSH, viti 2015:

Data e Ankandit	Data e Emetimit	Data e Maturimit	Yield-i mesatar i ponderuar i pranuar
30-Dec-14	5-Jan-15	4-Jan-16	3.45%
6-Jan-15	8-Jan-15	7-Jan-16	3.51%
27-Jan-15	29-Jan-15	28-Jan-16	3.54%
10-Feb-15	12-Feb-15	11-Feb-16	3.57%
24-Feb-15	26-Feb-15	25-Feb-16	3.59%
10-Mar-15	12-Mar-15	10-Mar-16	3.60%
24-Mar-15	26-Mar-15	24-Mar-16	3.57%
7-Apr-15	9-Apr-15	7-Apr-16	3.52%
28-Apr-15	30-Apr-15	28-Apr-16	3.48%
12-May-15	14-May-15	12-May-16	3.46%
26-May-15	28-May-15	26-May-16	3.39%
9-Jun-15	11-Jun-15	9-Jun-16	3.31%
23-Jun-15	25-Jun-15	23-Jun-16	3.28%
7-Jul-15	9-Jul-15	7-Jul-16	3.25%
28-Jul-15	30-Jul-15	28-Jul-16	3.22%
11-Aug-15	13-Aug-15	11-Aug-16	3.22%
25-Aug-15	27-Aug-15	25-Aug-16	3.21%
8-Sep-15	10-Sep-15	8-Sep-16	3.21%
22-Sep-15	25-Sep-15	22-Sep-16	3.21%
6-Oct-15	8-Oct-15	6-Oct-16	3.19%
27-Oct-15	29-Oct-15	27-Oct-16	3.18%
10-Nov-15	12-Nov-15	10-Nov-16	3.12%
24-Nov-15	26-Nov-15	24-Nov-16	2.83%
7-Dec-15	10-Dec-15	8-Dec-16	2.54%
22-Dec-15	24-Dec-15	22-Dec-16	2.26%
Mesatarja e periudhës			3.27%

(Burimi i të dhënave nga faqja zyrtare e internetit të Bankës së Shqipërisë, www.bankofalbania.org)

Zërat	Njësia	Realizuar nga KESH Gen. 6M i I-rë 2016
Materiale dhe Produkte	(000/lekë)	103,015
Personeli	"	556,026
Furnitura e Shërbime	"	246,268
Totali OPEX	(000/lekë)	905,309
Vlera e asetëve	(000/lekë)	35,542,234
Amortizimi i akumuluar	"	9,215,077
Vlera neto e Asetëve	(000/lekë)	26,327,157
Kapitali i Punës	(000/lekë)	75,442
Investime	"	3,676,121
Amortizim i periudhës	"	1,025,921
Baza e Rregulluar e Asetëve (RAB)	(000/lekë)	29,052,800
Kthimi i Lejuar mbi Kapitalin pas Taksave	(%)	3.27%
Raporti i Synuar i Kapitalit të Vet	"	40.00%
Kosto Mesatare e borxhit	"	1.84%
Raporti i Synuar i Borxhit	"	60.00%
WACC (Weighted Average Cost of Capital)	(%)	2.41%
Fitimi	(000/lekë)	700,568
Kosto fikse/shërbim borxhi TEC Vlorë	" "	765,500
Shpenzime për interesa OD	" "	
Shlyerje OD	" "	
Të Ardhurat e Kërkuara	(000/lekë)	3,397,297
Energjia Neto e Prodhuar	MWh	2,456,014
Tarifa e kërkuar nga KESH GEN	lekë/kWh	1.38

2.3.2 REALIZIMI I PRITSHËM I TARIFËS PËR FPSH (1 JANAR 2016 – 30 QERSHOR 2016)

Kosto totale e blerjes së energjisë për periudhë 1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016 llogaritet të jetë 10,012,953 mijë lekë.

Shpenzime personeli, materiale, furnitura dhe shërbime, shpenzime për interesa llogaritet të jenë 780,058 mijë lekë.

Energjia e shitur për klientë tariforë të OSHEE llogaritet të jetë 2,264,602 MWh.

Tarifa e FPSH-së për periudhën 1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016 llogaritet në 4.58 lekë/kWh.

Zërat	Njësia	Realizuar nga FPSH 6M i I-rë 2016
Blerë energji nga Prodhuesi Publik për klientët tariforë të OSHEE	(MWh)	1,303,796
Çmimi i prodhimit të energjisë elektrike	(lekë/kWh)	1.38
Kosto Totale e Prodhimit Publik	(mijë lekë)	1,803,484
Importi i energjisë	(MWh)	90,880
Kosto e Importit	(lekë/kWh)	8.01
Kosto Totale e Importit	(mijë lekë)	727,916
Blerje energjie nga PVE	(MWh)	768,744
Çmimi i PVE	(lekë/kWh)	7.448
Kosto Totale e PVE	(mijë lekë)	5,725,604
Blerje energjie nga TEC Vlorë	(MWh)	(1,070)
Kosto e TEC Vlorë	(lekë/kWh)	
Kosto Totale e TEC Vlorë	(mijë lekë)	
Blerje energjie nga Hec Ashta	(MWh)	137,500
Çmimi i Hec Ashta	(lekë/kWh)	8.18
Kosto Totale e IPP të ndarë	(mijë lekë)	1,124,155
Blerje energjie nga HEC Lanabregas	(MWh)	19,990
Çmimi i HEC Lanabregas	(lekë/kWh)	7.448
Kosto Totale e IPP të ndarë	(mijë lekë)	148,885
Kosto Totale e Energjisë	(mijë lekë)	9,530,045
Shpenzime për personelin	(mijë lekë)	15,049
Materiale	"	828
Furnitura e Shërbime	"	4,610
Shpenzime për interesa	"	759,571
Totali i të Ardhurat të Kërkuara	(mijë lekë)	10,310,102
Marzhi i Fitimit (0.5% e të ardhurave)	(mijë lekë)	51,551
Totali i të Ardhurave të Kërkuara Neto	(mijë lekë)	10,361,653
Energjia e shitur	MWh	2,264,602
Klientë Tariforë	" "	2,264,602
Tarifa e FPSH	lekë/kWh	4.58

Gjatë periudhës 1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016 janë realizuar dhe të ardhurat e tjera si më poshtë:

Energji e shitur me çmime tregu	MWh	650,719
Çmimi i shitjes	(lekë/kWh)	2.86
Të Ardhura nga shitja me çmime tregu	(mijë lekë)	1,859,398
Energji e shitur për mbulim humbje OSHEE	MWh	402,375
Çmimi i shitjes	(lekë/kWh)	3.92
Të Ardhura nga shitja mbulim humbje OSHEE	(mijë lekë)	1,576,403
Total Të Ardhura të tjera	(mijë lekë)	3,435,801

Tarifa e FPSH-së e axhustuar me të ardhurat e realizuara për energjinë elektrike të shitur me çmime tregu dhe atë të shitur për mbulim humbje OSHEE për periudhën 1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016 llogaritet në 3.06 lekë/kWh.

3 KËRKESA E KESH PËR TARIJËN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2016

3.1 PARASHIKIMI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Treguesit mujorë të prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2016 janë parashikuar për prurje me 75% siguri. Parashikimi është i lidhur me shfrytëzimin optimal të burimeve hidrike, që sigurohet nga mbajtja e niveleve optimale në liqenin e Fierzës dhe ruajtja e rezervës energjetike në fund të vitit, të konsideruar mjaftueshmërisht të nevojshme për një nivel normal të sigurisë së furnizimit, si dhe në mesataren shumëvjeçare të rregjimit racional të prodhimit nga HEC-et në kaskadën e Drinit. Mbështetur në parashikimet e pritshmërisë së vitit 2016, niveli i Fierzës në 31 Dhjetor 2016 pritet të jetë 280 m.

Theksojmë se HEC Koman është në fazë rehabilitimi në kuadër të projektit të Sigurisë së Digave. Rehabilitimi i agregateve të HEC Koman parashikohet të zgjasë deri në vitin 2017. Sipas skedulit të zbatimit të projektit, HEC Koman do të jetë në operim me një agregat më pak gjatë kësaj periudhe.

Prodhimi bruto i energjisë elektrike për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016 është parashikuar të jetë në sasinë 1,689 GWh. Ecuria aktuale e prodhimit të energjisë elektrike nga KESH monitorohet në dinamikë muaj pa muaj, duke bërë më pas korrigjimet përkatësisht me nivelin e prurjeve në kaskadë.

Bashkëlidhur ecuria e prodhimit bruto të energjisë elektrike mbi baza mujore nga të tre njësitë gjeneruese për periudhën e pesë viteve të fundit (2011 – 2015) dhe pritshmëria për vitin 2016.

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	6M-I	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	6M-II	Viti 2011
HEC Fierzë	305,321	143,379	126,084	67,032	39,508	74,273	755,598	97,120	106,278	82,849	110,080	60,092	23,960	480,377	1,235,975
HEC Koman	313,950	171,630	174,080	104,730	97,200	95,350	956,940	101,690	114,730	90,870	128,110	77,430	149,230	662,060	1,619,000
HEC Vau i Dejës	153,415	86,554	90,748	53,894	49,491	46,492	480,594	49,505	54,787	44,796	64,247	37,783	84,021	335,139	815,733
TOTAL HEC-e	772,686	401,563	390,913	225,656	186,199	216,115	2,193,132	248,315	275,795	218,515	302,436	175,305	257,210	1,477,577	3,670,708

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	6M-I	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	6M-II	Viti 2012
HEC Fierzë	111,771	102,564	37,835	18,822	89,961	192,932	553,883	179,355	138,175	148,545	48,824	36,775	123,983	675,657	1,229,540
HEC Koman	159,822	143,088	98,380	144,590	155,330	200,740	901,950	170,330	136,450	162,580	113,790	131,450	228,010	942,611	1,844,561
HEC Vau i Dejës	85,967	77,773	47,719	84,444	82,219	101,650	479,772	83,151	65,351	80,552	63,794	72,495	128,185	493,528	973,300
TOTAL HEC-e	357,559	323,425	183,934	247,856	327,509	495,322	1,935,605	432,836	339,976	391,677	226,408	240,720	480,178	2,111,795	4,047,401

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	6M-I	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	6M-II	Viti 2013
HEC Fierzë	172,775	147,008	174,211	311,947	297,940	226,430	1,330,310	160,882	149,082	97,334	79,010	74,790	163,676	724,774	2,055,084
HEC Koman	265,510	209,430	270,400	245,100	298,380	254,900	1,543,720	169,670	151,430	117,920	138,080	161,590	186,990	925,680	2,469,400
HEC Vau i Dejës	148,733	111,923	127,645	161,555	166,285	132,535	848,676	82,569	71,694	57,768	74,000	86,167	94,008	466,206	1,314,882
TOTAL HEC-e	587,018	468,361	572,256	718,602	762,604	613,865	3,722,706	413,121	372,206	273,022	291,090	322,546	444,675	2,116,660	5,839,366

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	6M-I	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	6M-II	Viti 2014
HEC Fierzë	99,928	54,964	97,464	34,144	43,924	83,680	414,105	118,140	138,469	99,574	106,049	79,026	100,939	642,197	1,056,302
HEC Koman	176,900	117,720	131,600	109,650	98,831	125,300	760,001	126,250	137,350	123,750	134,090	123,640	161,790	806,870	1,566,871
HEC Vau i Dejës	96,508	64,650	66,225	61,101	52,707	64,551	405,742	61,132	65,231	61,767	65,331	63,077	84,242	400,780	806,522
TOTAL HEC-e	373,336	237,335	295,289	204,895	195,462	273,531	1,579,848	305,522	341,049	285,091	305,470	265,743	346,971	1,849,846	3,429,694

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	6M-I	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	6M-II	Viti 2015
HEC Fierzë	119,996	210,195	191,829	179,918	208,653	123,129	1,033,720	150,917	142,178	120,761	38,615	53,846	97,871	604,188	1,637,908
HEC Koman	174,850	229,250	223,270	202,950	230,860	135,100	1,196,280	140,550	144,275	126,211	67,958	106,164	122,452	707,610	1,903,890
HEC Vau i Dejës	89,344	117,764	116,932	101,234	107,450	64,074	596,798	64,637	66,432	60,386	33,909	55,281	56,579	337,224	934,022
TOTAL HEC-e	384,190	557,210	532,031	484,102	546,963	322,303	2,826,798	356,104	352,885	307,357	140,483	215,291	276,902	1,649,021	4,475,819

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	6M-I	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	6M-II	Viti 2016
							(Parashikim)								(Parashikim)
HEC Fierzë	64,200	198,097	272,375	71,514	155,000	90,590	851,776	117,400	104,680	96,670	98,000	70,000	120,750	607,500	1,459,276
HEC Koman	161,828	237,578	271,285	114,995	188,238	110,110	1,084,034	119,029	104,238	103,438	112,848	116,450	165,176	721,180	1,805,214
HEC Vau i Dejës	86,998	115,633	147,086	55,415	93,246	52,830	551,208	56,092	48,276	49,346	57,365	61,367	87,570	360,016	911,224
TOTAL HEC-e	313,026	551,308	690,746	241,925	436,484	253,529	2,487,018	292,521	257,194	249,454	268,213	247,818	373,496	1,688,695	4,175,714

3.2 LLOGARITJA E TARIFËS SË PRODHIMIT DHE TREGTIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Shpenzime Materiale dhe Produkte – Për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016 shpenzimet për materiale dhe produkte pritet të realizohen në vlerën prej 108 milion Lekë. Për vitin 2016 këto shpenzime janë planifikuar në rreth 226 milion lekë bazuar në nevojën për mirëmbajtje të njësive të prodhimit, Aparatit Qendër dhe shoqërisë TEC Vlora sh.a.

Shpenzimet e personelit

Bazuar në treguesit operacional të vitit 2015 dhe në treguesit e aprovuar të Programit të Ndryshuar Ekonomiko-Financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2016, shpenzimet e personelit për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016 parashikohen të jenë 557 milion lekë. Duke qenë se TEC Vlora sh.a. vazhdon të jetë në status konservimi, detyrimet dhe shpenzimet e kësaj shoqërie vazhdojnë të mbulohen nga aktiviteti i KESH sh.a.. Për këtë arsye edhe shpenzimet përkatëse janë llogaritur si pjesë e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike.

Numri mesatar i punonjësve të KESH Total është 750 duke përfshirë dhe personelin e KESH Qendër dhe TEC Vlora sh.a. Më poshtë gjeni treguesit e punës për të tre njësitë e prodhimit, Aparatin Qendër dhe TEC Vlora sh.a..

(mijë lekë)	KESH Total	Aparati Qendër	TEC Vlora	KESH Gen.	HEC Fierzë	HEC Koman	HEC Vau i Dejës
Shpenzime Personeli	556,807	230,833	35,832	290,142	99,429	97,870	92,844
Fond për pagat	278,759	118,677	21,917	138,165	46,102	46,302	45,761
Vjetërsia në punë	38,080	17,081	0	20,999	6,885	6,707	7,407
Shtesa mbi paga (a+b)	20,100	756	1,151	18,193	6,249	5,863	6,081
a-Orë jashtë Orari	6,777	140	0	6,637	2,279	2,300	2,058
b-Shtesa Turni	13,323	616	1,151	11,557	3,970	3,563	4,024
Ushqim ditor dhe të tjera	47,400	14,616	3,596	29,188	9,764	9,974	9,450
Udhëtim e dieta	14,330	9,963	400	3,967	2,226	1,334	407
Sigurime shoqërore	65,624	27,190	4,450	33,985	11,797	11,232	10,956
Paga e 13-të	46,471	19,780	3,664	23,028	7,684	7,717	7,627
Shpenzime të tjera personeli	46,042	22,770	655	22,617	8,722	8,740	5,155
Treguesit e Punës							
Numri mesatar i punonjësve	750	235	62	453	155	148	150
Paga mesatare mujore	61,947	84,168	58,917	50,833	49,572	52,142	50,846

Shpenzimet për furnitura dhe shërbime – Për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016 pritet të realizohen në vlerën prej 512 milion lekë. Për vitin 2016 këto shpenzime janë planifikuar në rreth 763 milion lekë bazuar në nevojën për furnitura dhe shërbime të njësive të prodhimit, Aparatit Qendër dhe shoqërisë TEC Vlora sh.a.

Shpenzimet e Amortizimit – Për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016 pritet të jenë në vlerën prej 1,033 milion lekë. Për vitin 2016 këto shpenzime janë planifikuar në rreth 2,059 milionë lekë.

Për vitin 2016, bazuar dhe në Investimeve a parashikuara të kryhen si pjesë e Programit Ekonomiko-Financiar të shoqërisë, shtesat në aktivet afatgjata pritet të jenë rreth 7,352 milion lekë, nga të cilat 1,976 milion lekë nga Projekti i Sigurisë së Digave, i cili financohet nga kreditorët e huaj.

Baza e Aktiveve të Rregulluara (RAB)

Llogaritja e RAB bazohet në koston historike të aktiveve afatgjata në përdorim deri më 30.06.2016, kapitalin e punës, i cili për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016, që llogaritet i barabartë me 1/12 e OPEX –it të planifikuar. Llogaritja e kapitalit të punës bazohet në ritmin e shlyerjes së faturave të shitjes së energjisë elektrike, për atë pjesë të energjisë së shitur për mbulimin e kërkesës së klientëve tariforë. Arkëtimi i faturës mujore të shitjes së energjisë elektrike bazohet në Marrëveshjen për furnizim me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë OSHEE sh.a. (furnizuesi publik me pakicë) për vitin 2015, miratuar nga ERE me vendimin nr. 11 datë 04.02.2015, shtesat e aktiveve që pritet të kapitalizohen brenda periudhës 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016 (3,676 milionë lekë) dhe amortizimin e AQT-ve përperiudhën, që llogaritet të jetë 1,033 milionë lekë.

Llogaritja e Kosos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit (WACC)

Kthimi mbi kapitalin (ROE): bazohet në rezultatet e ankandeve të Bonove të Thesarit 12 mujore të kryera nga Banka e Shqipërisë gjatë periudhës Janr-Prill 2016. Mesatarja e periudhës e llogaritur deri në ankandin e fundit të zhvilluar për TB 12M është 1.73 %.

Rezultatet e ankandeve të Bonove të Thesarit 12 Mujore BSH, periudha 1 Janar 2016 – 30 Prill 2016:

Data e Ankandit	Data e Emetimit	Data e Maturimit	Yield-i mesatar i ponderuar i pranuar
5-Jan-16	7-Jan-16	5-Jan-17	2.21%
26-Jan-16	28-Jan-16	26-Jan-17	2.00%
9-Feb-16	11-Feb-16	9-Feb-17	1.85%
23-Feb-16	25-Feb-16	23-Feb-17	1.71%
8-Mar-16	10-Mar-16	9-Mar-17	1.67%
21-Mar-16	24-Mar-16	23-Mar-17	1.59%
31-Mar-16	4-Apr-16	3-Apr-17	1.55%
5-Apr-16	7-Apr-16	6-Apr-17	1.55%
24-Apr-16	28-Apr-16	27-Apr-17	1.46%
Mesatarja e periudhës			1.73%

(Burimi i të dhënave nga faqja zyrtare e internetit të Bankës së Shqipërisë, www.bankofalbania.org)

Kosto mesatare e borxhit: llogaritet në metodologjinë e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike, si raport i shumës totale të interesave neto për t'u paguar për kontratat e kredive afatgjata të KESH me gjendjen e principalit të këtyre kredive që KESH ka detyrim për të paguar. Kosto mesatare e borxhit e llogaritur për vitin 2016 është 1.84 %.

WACC – llogaritet mbi 60% e Interesit Mesatar të Kredive Afatgjata + 40% e ROE

$$\text{WACC 2016 (\%)} = (60\% \times 1.84\% + 40\% \times 1.73\%) = 1.80\%$$

$$\text{Fitimi (Kthimi mbi Bazën e Aktiveve të Rregulluara)} = \text{RAB} \times \text{WACC}$$

Llogaritja e të ardhurave të kërkuara të KESH për veprimtarinë e prodhimit dhe tregtimin të energjisë elektrike përfshin elementët e mëposhtëm:

OPEX: Materiale dhe Produkte, Shpenzime Personeli, Furnitura dhe Shërbime: 1,177,205 (mijë lekë)

Amortizimi i periudhës 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016: 1,033,006 (mijë lekë)

Fitimi (Kthimi mbi RAB): RAB x WACC: 522,326 (mijë lekë)

Kosto fikse/Shërbim borxhi TEC Vlorë: Bazuar në përshkrimin e gjendjes së shoqërisë TEC Vlorë sh.a. si më sipër dhe në llogaritjen e tarifës së KESH Gen për vitin 2015, kosto fikse e shërbimit të borxhit për TEC Vlorë për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016 llogaritet të jetë rreth 783 milionë lekë.

Shpenzime për interesa OD: Duke qenë se duke filluar nga data 1 Korrik 2016, KESH sh.a. nuk do ta ketë më funksionin e Furnizuesit Publik me Shumicë, elementë të tarifës së FPSH-së, të cilët mbeten për t'u mbuluar si pjesë e aktivitetit të KESH sh.a. bëhen pjesë e tarifës së prodhimit dhe tregtimin të energjisë elektrike nga KESH. Referuar Planit për Rimëkëmbjen financiare të Sektorit të Energjisë Elektrike, miratuar me VKM 171/2015, në të cilin nuk parashikohet që për vitin 2016 dhe për 2 vitet në vazhdim, OSHEE sh.a të paguajë detyrimet e prapambetura që ka ndaj KESH për energjinë e lëvruar gjatë periudhës 2012-2014, KESH sh.a do të vazhdojë të ketë detyrimin për pagesat e interesave të overdrafteve. Këto interesa për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016 llogariten të jenë rreth 760 milionë lekë.

Skedulim shlyerje OD: Gjendja e kredive afatshkurta (Overdrafts) që shoqëria KESH sh.a. ka me bankat e nivelit të dytë në fund të vitit 2015 është 32.9 miliardë lekë. Kostot që shoqërojnë këto kredi, ku përfshihen interesat, komisionet e rinovimit, penalitetet në rast vonese pagesash llogariten në rreth 1.5 miliardë lekë në vit.

Duke qenë se këto kredi afatshkurta janë marrë kryesisht në kushtet e ushtrimit të funksionit të FPSH për:

- i) pamundësinë e mbulimit të shpenzimeve për importin e energjisë elektrike;
- ii) përballimin e kostove shtesë (kosto të panjohura në tarifën e miratuar me parë) si pasojë e rritjes së sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et Private dhe me Koncesion,

referuar parashikimeve ligjit Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike, VKM Nr. 244/2016 si dhe në kuadër të rishikimit të portofolit të kredive afatshkurtra me garanci qeveritare dhe shndërrimit të tyre në kredi afatgjatë si pjesë e marrëveshjes që pritet të nënshkruhet ndërmjet KESH sh.a dhe BERZH (EBRD), shoqëria KESH sh.a e vlerëson të nevojshme skedulimin e shlyerjes së pjesës së mbetur të këtyre kredive (rreth 16.5 miliardë lekë) në një hark kohor mesatarisht prej 15 vjetësh me një pagesë vjetore prej 1.1 miliardë lekë.

Kompensimi Mundshëm Financiar i Furnizuesit të Shërbimit Universal: Në bazë të pikës 3 nenit 5 për Detyrimin e Shërbimit Universal të Furnizimit të VKM nr. 244 datë 30.03.2016 Në rastet kur Furnizuesi i Shërbimit Universal nuk mund të sigurojë sasinë e nevojshme nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, sipas përcaktimeve të vendosura në pikën 2, të këtij neni, Furnizuesi i Shërbimit Universal ka detyrimin që të sigurojë sasinë e nevojshme të energjisë në tregun e parregulluar. Furnizuesi i Shërbimit Universal kompensohet nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, për sasinë e siguruar në tregun e parregulluar, sipas diferencës ndërmjet çmimit të rregulluar të prodhimit të energjisë elektrike dhe çmimit mesatar të bursës hungareze HUPX, për periudhën

në të cilën është kryer livrimi i energjisë, për produktin/profilin në bandë, siç publikohet në ëbsite-in e kësaj burse (www.hupx.hu).

Më poshtë llogaritja e të ardhurave dhe tarifës së kërkuar për veprimtarinë e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike si detyrim i shërbimit publik për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016.

Zërat	Njësia	KESH sh.a. 6M i II-të 2016
Materiale dhe Produkte	(000/lekë)	108,279
Personeli	"	556,807
Furnitura e Shërbime	"	512,119
Totali OPEX	(000/lekë)	1,177,205
Vlera e asetëve	(000/lekë)	39,218,356
Amortizimi i akumuluar	"	10,240,998
Vlera neto e Aseteve	(000/lekë)	28,977,358
Kapitali i Punës	(000/lekë)	98,100
Investime	"	3,676,121
Amortizim i periudhës	"	1,033,006
Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB)	(000/lekë)	31,718,573
Kthimi i Lejuar mbi Kapitalin pas Taksave	(%)	1.73%
Raporti i Synuar i Kapitalit të Vet	"	40.00%
Kosto Mesatare e borxhit	"	1.84%
Raporti i Synuar i Borxhit	"	60.00%
WACC (Weighted Average Cost of Capital)	(%)	1.80%
Fitimi	(000/lekë)	569,948
Kosto fikse/shërbim borxhi TEC Vlorë	" "	765,500
Shpenzime për interesa OD	" "	759,571
Shlyerje OD	" "	551,676
Të Ardhurat e Kërkuara	(000/lekë)	4,856,906
Energjia Neto e Prodhuar	MWh	1,667,165
Tarifa e kërkuar nga KESH sh.a.	lekë/kWh	2.91

Tarifa Mesatare e KESH sh.a. për Prodhimin dhe Tregtimin e Energjisë Elektrike tek OSHEE në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 244 datë 30.03.2016 për përcaktimin e Shërbimit të Detyrimit Publik për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016 llogaritet në 2.91 lekë/kWh.

3.3 KONKLUZIONE

Mbeten ende të pazgjidhura çështjet e mos reflektimit/axhustimit në tarifë, për sa i përket periudhave të mëparshme, të cilat lidhen me:

- Detyrimet për kostot e pa reflektuara në tarifën e FPSH për periudhën 2012 - 2014 të energjisë elektrike shtesë të blerë nga importi, PVE/PPE si dhe Hec Ashta,
- Detyrimet për kostot e pa reflektuara në tarifën e FPSH për periudhën 2012 - 2014 të interesave të OD-ve (rreth 2,6 miliardë lekë), të cilat janë marrë nga bankat e nivelit të dytë për të financuar blerjen e energjisë elektrike nga importi për mbulimin e humbjeve të OSHEE dhe plotësimin e kërkesës së klientëve tariforë,
- Të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i faturave të shitjes së energjisë së prodhuar për furnizimin e klientëve tariforë dhe energjisë së dhënë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën 2012 – 2014.

Vendosja e detyrimit për shërbim publik për shoqërinë KESH sh.a me VKM Nr.244/2016, akt nënligjor i cili shërben dhe si model i përkohshëm i tregut shqiptar të energjisë elektrike, përbën një përcaktim të qartë funksioneve dhe orienton veprimtarinë e shoqërisë në këtë sektor, marrëdhëniet e saj me partnerët, riorganizimin e strukturës së saj të brendshme si dhe do të mundësojë parashikime më të sakta të treguesve ekonomikë për vitet në vijim.

Parashikimet ligjore, nënligjore, rregullatore si dhe tarifa e re e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike do të krijojnë mundësinë e ushtrimit normal të veprimtarisë së shoqërisë KESH sh.a.

Miratimi i drejtë, transparent dhe në mënyrë jodiskriminuese i tarifës së prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike nga ana e ERE përbën një kusht të domosdoshëm për përmirësimin e situatës financiare të shoqërisë duke mundësuar që KESH sh.a të operojë vërtetë si një shoqëri tregtare ekonomikisht efiçente dhe financiarisht e pavarur nga Buxheti i Shtetit.